- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP<sup>1</sup>.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi

aktiv).

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_**

**Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_**

**Vula \_\_\_\_\_**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE  
LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## Shtojca 9

[ Shtojcë për t’u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;
- c. Sigurimin e ofertës, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 4;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;
- e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas pikës 1 të kësaj shtojce.

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Ne përmbushje të kapacitetit ekonomik dhe financiar, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar xhiro mesatare vjetore, gjatë tre viteve të fundit financiare, në një vlerë të pakten prej 4,500,000 (kater milion e pesëqind mijë) lekë.*

*Operatorët ekonomik që kanë aktivitet me pak se 3(tre) vite, duhet të kenë xhiro mesatare, në vlerën e kerkuar të pakten prej 4,500,000 (kater milion e pesëqind mijë) lekë.*

Si prove për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhiroja vjetore për vitet e sipërpermendura ose kopje të certifikuar të bilanceve.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, kontrata të ngjashme në një vlerë të pakten prej 4,500,000 (kater milion e pesëqind mijë) lekë.*

*Lidhur me këto pike:*

*Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e*



realizuar.

- 2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për mallrat dhe shërbimet objekt prokurimi. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*
- 2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë certifikatat e meposhtme ose ekuivalente (të perkthyer dhe noterizuara) dhe të vlefshme si vijon;*
- *ISO 9001:2015, në fushën e menaxhimit të cilësive, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit.*
  - *ISO 27001:2013 në fushën e menaxhimit të sigurisë së informacionit objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit.*
  - *ISO 20000-1:2011 ose ekuivalente në fushën për menaxhimin e sistemit të shërbimit IT.*
- 2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për mallrat objekt prokurimi. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo produkti që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produkti i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*
- 2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të cilesojë se mallrat e ofruara prej Tij, janë të reja dhe jo të rikonstruara.*
- 2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues për kryerjen e këtij shërbimi duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve jo më të vogël se 5 (të pesë) me kohë të plotë pune, ku tnder të cilët 3 (tre) duhet të jenë Inxhinierë Elektronik ose Informatikë, vërtetuar me kontratat e punës shoqëruar me diplomat përkatëse. Punonjësit duhet të jenë të siguruar të pakten për 6 (gjashtë) muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.*
- Lidhur me këto pike operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim të leshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në të cilin të jete i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar, shoqëruar me listepagesat përkatëse E-Sig, formularet e deklaramentit dhe mandatet e pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore.
- 2.3.7 *Operatori ekonomik ofertues për të bërë të mundur kryerjen e këtij projekti duhet të provojë se ka në stafin e tij kapacitetet teknike dhe profesionale si më poshtë vijon:*
- *Një **Menaxher Projekti** i cili duhet të jetë i diplomuar në nivel master për Shkenca Elektronike/Kompjuterike/Informatike/Telekomunikacion i certifikuar në PMP ose Prince2, . Punonjësi duhet të ketë jo më pak se 3 vite eksperience pune në fushën IT.*
  - *Për të garantuar sigurinë dhe disponueshmërinë e integritetit të sistemit backup me platformat ekzistuese **Microsoft**, operatori ekonomik duhet të ketë të pakten një punonjës ekspert të kualifikuar për **(MCSE) per Productivity** ose ekuivalente.*

*Punonjesi duhet të ketë jo më pak se 3 vite eksperience pune në IT.*

- *Per te garantuar menaxhimin sistemeve informatike **Microsoft** ekzistuese ne OST operatori ekonomik duhet te kete te pakten nje punonjës të kualifikuar **Microsoft Certified Server Administration (MSCA)**. Punonjesi duhet të ketë jo më pak se 3 vite eksperience pune në IT.*
- *Per te mundësuar replikimin dhe kalimin e makinave virtuale ekzistuese, operatori ekonomik duhet te kete te punesuar nje punonjës te **certifikuar per Virtualizim ne Server me HyperV ose VMware**.*
- *Per te garantuar sigurinë, integrimin dhe implementimin e zgjerueshmerise sipas kërkesave teknike, me platformat cloud, operatori ekonomik duhet te kete te pakten nje punonjës të kualifikuar për **MCSE: Cloud Platform and Infrastructure**.*

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

**Shenim: Ne respektim te nenit 23 te LPP-se ne te gjitha rastet kur permendet “marke” perfshihet termi “ekuivalente”.**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

### Me objekt: Implementimi i një sistemi Backup dhe Disaster Recovery

## 1. HYRJE

### 1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

### 1.2 Historiku

Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a është një shoqëri aksionare shtetërore, e krijuar me datë 14/07/2004, si rezultat i reformimit dhe ndarjes së Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare në tre shoqëri të veçanta. OST sh.a. garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:

1. Furnizimin e pa ndërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
2. Transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit;
3. Tranzitet dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit;

## 2. OBJEKTIVAT DHE QELLIMI

### 2.1 Objektivat

OST, nëpërmjet teknologjise së informacionit ka informatizuar dhe automatizuar një pjesë të madhe të proceseve të punës. Platformat dhe sistemet TI jane pike kyce dhe kryesore per mbarvajtjen e puneve dhe kryerjen e detyrave funksionale. Per te optimizuar menyren e menaxhimit te sistemeve informatike ne platforma teresisht te sigurta per garantimin dhe ruajtjen e disponueshmerise te sherbimeve dhe te te dhenave gjithashtu objekti kryesor eshte ndertimi i nje sistemi automatik per backup dhe restore te dedikuar per platformat dhe sistemet te cilat OST posedon.

### 2.2 Qëllimi

Me anë të këtij projekti OST synon të përmirësojë sigurinë dhe disponueshmerinë e të dhenave, pajisjet dhe infrastrukturën e saj për të përballuar zhvillimet teknologjike të kohës.

Qellimi është që të implementohet një zgjidhje sipas praktikave më të mira e menaxhimit sistemeve për Backup/Restore/Monitoring në platforma të sigurta për ruajtjen e disponueshmërisë të shërbimeve dhe të të dhënave gjithashtu, për aparat qendror dhe për përdoruesit e tjerë të shërbimeve në OST. Zgjidhje e dedikuar me platforma virtuale është një nga teknologjitë që ka aftësinë për të përmirësuar proceset e kryerjes së punëve dhe shërbimeve si dhe efikasitetin duke ofruar disponueshmëri më të madhe. Sistemi i automatizuar dhe shkallëzuar i backup është një nevojë e domosdoshme për tu përgjigjur nevojave të sotme që ka OST për shërbimet, sigurinë e informacionit si dhe për përdoruesit e shërbimeve të kompanisë.

Sa më sipër kërkohet që të gjithë pajisjet që do të blihen, instalohen dhe konfigurohen në ambientet e OST dhe të sigurohet transferimi i të dhënave nga magazinat (storage) ekzistuese në të reja që do të instalohen.

Në përfundim të këtij projekti OST do të ketë transferuar të gjitha sistemet/platformat në pajisjet e reja dhe do të ketë mundësinë të zhvillojë sisteme/programet sipas zhvillimeve më të reja teknologjike.

Afati realizimi të këtij projekti është 50 ditë. Projekti duhet të zhvillohet nga operatori ekonomik me çelës në dorë.

### **3. SITUATA AKTUALE**

Pajisjet fizike (makinat) në të cilat janë të vendosur dhe janë në operim sistemet dhe programet aktuale në OST gjenden të listuara si më poshtë:

<b>Blade server HP Proliant BL 460 C Gen8 (cluster 1 High Availability)</b>	
<b>3 cope</b>	
Cpu Cores	8 CPU x 2.399 Hz
Processor Type	Intel® Xeon® CPU E5-2609 @ 2.40GHz
Memory RAM	64 GB
HDD	2 x 146
<b>DELL PowerEdge R 430 Rack Mount</b>	
<b>2 cope</b>	
CPU Cores	8 CPU x 2.399 Hz
Processor Type	Intel® Xeon® CPU E5-2609 v3 @ 1.90GHz
Memory RAM	64 GB
HDD	5 x 500
<b>Sotrage DELL PowerVault 3820f</b>	
<b>1 cope</b>	
Modeli i HDD	SAS, NL-SAS, SSD,
Hard disc SSD	5x 1.92TB Solid State Drive (RAID 5 ; 7 TB )
Hard disc	5 x 1.8TB 10K RPM SAS ( RAID 5 ; 6 TB)

NLSAS	5x 1TB NLSAS 7.2K ( RAID 5 ; 3.7 TB)
<b>Backup Storage te DELL PowerVault</b>	
Hard disc	12x 300GB 10K RPM SAS ( RAID 6 ; 2 TB)
NLSAS	5x 1TB NLSAS 7.2K ( RAID 5 ; 3.7 TB)

Sistemet, platformat dhe programet aktuale te grupuara bazuar mbi teknologjine e virtualizimit jane te listuara si me poshte:

● **CLUSTER NR.1**

Infrastruktura virtuale e ngritur mbi teknologjine VMware (ESXi 5.5) perbehet nga VM :

- Webservice
- System financiar Oracle EBS
- System Raportimi BI
- Domain Controller 1
- Antivirus Server
- Sistemi i menaxhimit te Arkives Dixhitale
- Document Management System DMS
- ESA –Email Security
- Web Proxy
- File Server
- VCenter
- Access Control

● **CLUSTER NR.2**

Infrastruktura virtuale e ngritur teknologjine Hyper-V:

- Exchange Server 2016
- Domain Controller 2
- Sistemi i GPS
- Sistemi i qenderzuar i Printimit
- Application Server
- FTP Server
- System Center

**4. KERKESAT TEKNIKE TE PERGJITHSHME TE ZGJIDHJES BACKUP**

Nevojat e kompanise jane te levize te dhenat te cilat do te aksesohen shpesh ose ndryshe te

dhenat e nxehta dhe te dhenat te cilat do te aksesohen ne menyre jo frekvente ose ndryshe te dhenat e ftohta nga hapësira ruajtese ne arkitekturen e software-ve moderne duke i shkarkuar keto te dhena nga hapësira ruajtese.

Oferta duhet te perfshije kostot totale si dhe garancine e pajisjeve per nje vit (HW, Licensat, Suportin, Kontraten).

Zgjidhja duhet te jete e unifikuar nga nje prodhues i vetem, produktet fizike si dhe zgjidhja backup qe ofrohet.

## 5. PAJISJE HARDWARE

Më poshtë do të listohen modulet dhe parametrat teknike të cilat janë të domosdoshme për rritjen e kapaciteteve teknike dhe sigurise të ofruara për qendrën e të dhënave që ndodhet në ambientet e OST:

### 5.1 Kerkesat teknike te Sistemit Backup HW

<b>Tipi Pajisjes</b>	Modulare
<b>Sasia e Moduleve (nyje)</b>	Minimalisht 3
<b>CPU / Modul</b>	Minimalisht 2
<b>CPU Type</b>	Intel Xeon Bronze 3106 1.7GHz 8-Core CPUs ose me lart
<b>Kapaciteti HDD /modul</b>	Minimalisht 12 TB raw
<b>Kapaciteti Flash/modul</b>	Minimalisht 1,6 TB raw
<b>Kapaciteti boot SSD/modul</b>	Minimalisht 240 Gb
<b>Memorja Ram/Modul</b>	64 Gb

<b>Data Resiliency (aftesia e rikuperimi të dhenave)</b>	Faktor replikimi 2,3
<b>Prokollet</b>	NFSv3, SMB 2.1, SMB 3.0 ,S3 REST API etc
<b>Kodimi te dhenave</b>	AES256
<b>Power Supply</b>	2 x Redundant (1+1) PSUs with Pmbus
<b>Power Cords</b>	C13 to C14 (5-6m) Power Cord,
<b>Networking Interface / Modul</b>	(4) 10GbE (1) IPMI
<b>Data Resiliency (aftesia e rikuperimi të dhenave)</b>	Faktor replikimi 2,3
<b>Sizing / Modul</b>	Form factor: Rack (2U)
<b>Garancia</b>	1 vit

## 5.2 Kerkesat teknike te Sistemi Backup SW

Zgjidhja duhet te jete e bazuar ne teknologjine SDS te avancuar dhe minimalisht duhet te kete kapacitet neto (tre here me te madhe se kapaciteti aktual ne platformat teknologjike te OST e cila eshte 12TB) 36TB hard disk.

Kapaciteti totalit e dhenave te sistemit duhet te jete te pakten 36TB.

Sistemi duhet te perfshije te gjithë softwarët e nevojshem per depozitim per te depozituar minimalisht 28 TB te dhena.

Sistemi backup per efekt uljen e rrezik duhet te jete redundant duke u vendosur ne te pakten 3 nyje per te siguruar kodimin e fshirjes (EC) ne menyre qe te mbroje secilen nyje individuale nga deshtimi.

Sistemi i ofruar duhet te siguroje akses shume protokollesh ne te njejtat te dhena per te suportuar aplikacionet pergjate te gjithë sistemit kryesor operativ te ndermarjes.

Sistemi i ofruar duhet te siguroje mbeshtetje te ruajtjes se objekteve me API REST ne nivel aplikacioni minimalisht S3 duke bere te mundur keshtu integrim te lehte me sherbimet

ekzistuese.

Perditesimet e sistemit nuk duhet te jene te demshme per sistemin ose per te dhenat, per ta realizuar kete duhet qe shkallezimi te parashikohet te pakten ne sasine prej 5 TB.

Sistemi duhet te mbeshtese dedublikim global me konsistence strikte. Nese te dhenat ndryshohen ne pjesen kryesore, nevojitet ndryshim i automatizuar ne site primar dhe backup.

Sistemi duhet te suportoje hidratim te plote te imazheve dhe te ruaje imazhet e klonuara per rikthim te shpejte.

Kompresimi i te dhenave duhet te jete te pakten 2-fish.

RPO (Objektivi i Rikuperimit te te Dhenave) per 100 VM (makina virtuale) duhet te jete shume i shpejte (me pak se 5 minuta) nga depozitimi i te dhenave ne site primar te backup.

Sistemi duhet te kete sherbime te replikimit te integruara, granulare dhe te sigurta per redundance.

Metadat e objekteve duhet te indeksohen ne menyre qe te mundesojne kerkim ne te gjitha objektet ne nje grup.

Sistemi duhet te kete regulla per kualitetin e sherbimit (QoS) ne menyre qe te permiresoje performancen per tipe te ndryshme ngarkesash.

Sistemi duhet te suportoje enkriptim bazuar ne algoritmin AES 256-bit per te dhenat qe jane jo aktive dhe per te dhenat qe jane ne perdorim. Platforma duhet te jete ne perputhje me FIPS-2.

Duhet te suportoje mbeshtetje te gjate per te dhenat e ruajtura.

Sistemi duhet te suportoje integrimin ne cloud me qellim te jete i afte te arkivoje te dhenat ne cloud publik per nje kohe te gjate nese do te kerkohet ne te ardhmen.

Sistemi duhet te mundesoje shfrytezimin e burimeve ne cloud per zgjerueshmerine e kapacitetit nese do nevojitet. Duhet te depozitoje te dhenat ne cloud me qellim rikuperim ne rastin e fatkeqesive.

### **5.3 Instalimi dhe Konfigurimi.**

Për të gjitha pajisjet e kërkuara duhet që të instalohen dhe konfigurohen në ambientet e OST. Instalimi duhet të kryhet në ambientet teknologjike të percaktuara në praninë e stafit të Teknologjisë duke siguruar kështu edhe trajnimin e stafit gjatë periudhës së instalimit, dhe me vone gjate kalimit ne operim dhe funksional te ketij sistemi. Konfigurimet e pajisjeve duhet të



bëhen sipas sipas komunikimeve me shkrim nga OST për këtë arkitekturë që ofron sistemi ekzistues.

Eshtë detyrim i operatorit ekonomik që të ofrojë licensimin e plotë të sistemit backup për gjithë serverat e paraqitur në situatën aktuale. Mospërbushja e këtij kriteri konsiderohet si realizim jo i plotë i kontratës.

*Afati realizimi të kontratës është: 60 dite*

## **6. TABELA ME ZËRAT**

Me poshtë gjendet tabela me zerat e kërkuar në këtë projekt:

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Vite Garanci</b>
1	F.V. Sistem Backup HW (module)	copë	3	1
2	F.V. Sistem Backup Software SW	copë	1	1
3	Sherbim i instalim dhe konfigurimit të Sistemit Backup HW + SW	copë	1	1
4	Sherbim i transferimit të dhenave nga Infrastruktura ekzistuese VM	vite	1	1

**Shenim: Në respektim të nenit 23 të LPP-se në të gjitha rastet kur përmendet “marke” përfshihet termi “ekuivalente”.**

**Shtojca11**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>		
<b>02</b>		
<b>03</b>		
<b>...</b>		

## Shtojca 12

( Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Vite Garanci
1	F.V. Sistem Backup HW (module)	copë	3	1
2	F.V. Sistem Backup Software SW	copë	1	1
3	Sherbim i instalim dhe kofigurimit te Sistemit Backup HW + SW	copë	1	1
4	Sherbim i transferimit te dhenave nga Infrastruktura ekzistuese VM	vite	1	1

Afatet e lëvrimit: 2 (dy) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

### Shtojca 13

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

#### NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>1</sup>

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< Emri >

### Shtojca 14

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

\* \* \*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

\* \* \*

[ Titullari i autoritetit kontraktor]

## Shtojca 15

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**



## Shtojca 16

### KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat – Tender i Hapur

#### Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi,

- tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikant e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që

kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

#### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

#### **Neni 6: Pronësia Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikave, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t’i përdorë për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t’i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Mallrave**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.

- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

#### **Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet**

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

#### **Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike**

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitësit (Kontraktuesit).

#### **Neni 10: Pjesët e Këmbimit**

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

### **Neni 11: Ambalazhimi**

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
